

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN - Departamenti Për Krime të Rënda, përmes kryetarit të trupit gjykues- gjyqtarit Agim Ademi dhe gjyqtarëve anëtar të trupit gjykues Naser Maliqi dhe Veli Kryeziu, me sekretaren juridike Naile Neziri, në lëndën penale kundër të akuzuarve D.S., nga fshati ..., Komuna e ..., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat A.L. nga ..., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar 422 paragrafi 1 të KPRK-ës, S.M. nga fshati ... Komuna e ..., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat V.I. nga ..., V.K., nga fshati ..., Komuna e ..., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat B.H. nga ..., Z.S. nga fshati ... Komuna e ..., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat M.A., nga ... për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, dhe F.E. nga fshati ... Komuna e ..., të cilin sipas detyrës zyrtare e mbron avokat E.Q., nga ..., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar 422 paragrafi 1 të KPRK-ës, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti i Krimeve të Rënda PP.I. nr. 44/2015 të datës 24.08.2014 të cilën e përfaqëson prokurori i shtetit Arben Kadriu, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor dhe publik, më datën 23.12.2016, bie dhe në prezencë të palëve me datë 27.12.2016 publikisht shpalli këtë:

AKT GJYKIM

Të akuzuarit:

D.S., nga i ati S., dhe nëna S., e lindur V., i lindur ..., në ... tani jeton në fshati ... Komuna e ..., i martuar, baba i tre fëmijëve, i punësuar në Komunën e ..., ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, i gjendjes së mesme ekonomike, Serb, Shtetas i Republikës së Kosovës.

S.M. nga i ati R., dhe nëna P., e lindur B., i lindur me datë ..., në ... tani jeton në fshati ... Komuna e ..., i martuar, baba i një fëmije, i punësuar në Komunën e..., ka të kryer shkollën e lartë ekonomike, i gjendjes së mesme ekonomike, Serb, Shtetas i Republikës së Kosovës.

V.K., nga i ati V., dhe nëna Zh., e lindur K., i lindur ..., në ... tani jeton në në fshati ..., Komuna e ..., i martuar, baba i një fëmije, i punësuar në Komunën e ..., ka të kryer shkollën e mesme ekonomike, i gjendjes së mesme ekonomike, Serb, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Z.S., nga i ati A., dhe nëna V., e lindur A., i lindur ..., në fshatin ... Komuna e ... ku edhe jeton, i ve, baba i tre fëmijëve, i punësuar në Komunën e ..., (në masë të suspendimit) ka të kryer fakultetin filozofik dega sociologji-filozofi, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

F.E., nga i ati L., dhe nëna N., e lindur S., i lindur ..., në ..., tani jeton në fshatin ... Komuna e ..., i martuar, baba i dy fëmijëve, i punësuar në një kompani ndërtimore " ... " me seli në ..., ka të kryer fakultetit e gjeodezisë, i gjendjes së mesme ekonomike, Shqiptar, Shtetas i Republikës së Kosovës.

Bazuar në nenin 364 pika 1.3. të KPPRK-ës.

LIROHEN NGA AKUZA

I.

I akuzuari D.S.,

Se me datë 08.11.2013, i akuzuari në cilësinë e organit mbikëqyrës për implementimin e projektit, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, me qëllim që të përfitojë për vete ose personin tjetër, apo ti shkaktoi dëm personit tjetër, në mënyrë kundërligjshme dhe në kundërshtim me interesat dhe qëllimet e Komunës së Klllokotit, nuk i ka kryer punët dhe detyrat e tij për të cilat ka qenë i autorizuar sipas vendimit të Organit mbikëqyrës nr. ... të datës 29.10.2013, ashtu që nuk i ka ndërmarrë veprimet zyrtare të nevojshme që ka qenë i detyruar ti ndërmerre, për raportim të drejtë lidhur me përmbushjen e kontratës për implementimin e projektit ... të datës 21.10.2013, dhe me këtë ka lënë pas dore interesat dhe qëllimet e Komunës së Klllokotit, duke i zëvendësuar ato me interesat e veta ose interesat e kompanisë " .. " për ti sjellë dobi financiare, vetes apo kompanisë në fjalë ashtu që ka përpiluar një raport me shkrim ku ka konstatuar se punimet sipas kontratës në fjalë janë përmbushur sipas planit dinamik të veprimit dhe sipas kushteve të kontratës në përpikëri, në atë mënyrë që nga fshehja e gjendjes reale në teren dhe mos raportimi i drejtë për të metat në përmbushjen e kontratës për asfaltimin e rrugicave të fshatit ..., bazuar në ekspertizën e inxhinierit të ndërtimtarisë, i ka shkaktuar Komunës së Klllokotit dëm në vlerë prej 9.573,07 euro.

Me çka kishte me kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtare nga neni 422 par.1, të KPRK-ës.

II.

Të akuzuarit S.M., V.K. dhe Z.S.,

Të akuzuarit në cilësinë e komisionit për pranimin teknik në kuadër të Komunës së Klllokotit, duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, me qëllim që të përfitojnë çfarëdo dobie për vete ose personit tjetër, në mënyrë të kundërligjshme dhe në kundërshtim me interesat dhe qëllimet e Komunës së Klllokotit, nuk i kanë ndërmarrë veprimet zyrtare të nevojshme që kanë qenë të detyruar ti ndërmarrin si komision për vlerësimin e gjendjes reale, të asfaltimit të rrugës në fshatin ..., sipas vendimit 48531/1, të datës 11.07.2014, për vërtetim të drejtë të gjendjes reale lidhur me përmbushjen e kontratës, ashtu që me datë 25.11.2013, si komision për pranimin e punimeve nga kompania SHPK " ..." kanë dal në terren dhe kanë përpiluar procesverbal për pranim teknik, duke konstatuar se të gjitha aktivitetet e planifikuara sipas projektit ... të datës 21.10.2013, janë kryer sipas projektit, kinse pa të meta, e njëkohësisht pas vërtetimit të gjendjes në teren janë pajtuar që kompanisë në fjalë ti përfundohet pagesa, kështu që nga mos vlerësimi i drejtë i gjendjes në terren, kanë ndikuar në mos kompensimin e të metave konform planit dinamik dhe para masave, e që bazuar në ekspertizën e inxhinierit të ndërtimitarisë i kanë shkaktuar Komunës së Klllokotit dëm në vlerë prej 9.573,07 euro.

Me çka në bashkëkryerje kishin me kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1. lidhur me nenin 31 të KPRK-ës.

III.

I akuzuari F.E..

Në cilësinë e menaxherit të kompanisë " ..." me seli në ..., duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar, ka tejkalluar kompetencat e tij zyrtare, me qëllim që të përfitojë çfarëdo dobie për vete ose për personin tjetër, apo që ti shkaktojë dëm personit tjetër, ashtu që më datë 18.11.2013, edhe pse ka qenë në dijeni se punët ndërtimore nuk i ka përfunduar sipas planit dhe para masës, ka përpiluar kërkesë për pranim teknik dhe faturë me përmbajtje të pavërtetë, kinse punët janë kryer sipas planit dhe para masës sipas kontratës ... të datës 21.10.2013, për asfaltimin e rrugicave në fshatin ..., e cila kërkesë bie në kundërshtim me Raportin e Komisionit për vërtetimin e gjendjes faktike të ndërtimit të rrugës në fshatin ... me numër të protokollit nr. ... të datës 14.07.2014, ku në bazë të ekspertizës dallimi i kërkesës për pranim teknik dhe procesverbalit për pranim teknik dhe punëve të kryera është 250.70 metra rrugë asfalt të pa kryera.

Me çka në bashkëkryerje kishin me kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës ose autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1. të KPRK-ës.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës.

Arsyetim

Prokuroria Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda ka ngritur aktakuzë PP.I.nr.44/2015 të datës 24.08.2015, kundër të akuzuarit D.S., nga fshati ..., Komuna e ..., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1, të KPRK-ës, të akuzuarve S.M., V.K. dhe Z.S. për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar 422 paragrafi 1 lidhur me nenin 31 të KPRK-ës, si dhe kundër të akuzuarit F.E., për shkak të veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 paragrafi 1, lidhur me nenin 31 të KPRK-ës dhe ka kërkuar që të akuzuarit të shpallen fajtorë dhe të dënohen me dënim meritator sipas ligjit.

Prokurori i Prokurorisë Themelore në Gjilan - Departamenti për Krime të Rënda Arben Kadriu, në fjalën përfundimtare duke mbetur pranë aktit akuzues theksoi se i akuzuari D.S., në cilësinë e organit mbikëqyrës për implementimin e projektit me datë 08.11.2013, me qëllim përfitimi për vete apo personit tjetër dhe që të i shkaktoi dëm Komunës së Kllkotit duke qenë i autorizuar me vendimin të Organit Mbikëqyrës nr. ... të datës 29.10.2013, nuk i ka ndërmarr veprimet lidhur me përmbushjen e kontratës për implementimin e projektit ..., të datës 21.10.2013, ashtu që ka dëmtuar interesat e Komunës së Kllkotit duke i shkaktuar përfitim të kundërligjshëm pasuror të kompanisë “ ... ” në atë mënyrë që ka përpiluar raport me shkrim duke konstatuar se punimet sipas kontratës janë përmbushur, ashtu që bazuar në ekspertizën e ekspertit i ka shkaktuar dëm Komunës së Kllkotit në vlerë prej 9.573,07 euro. Pas ndërrimit të qeverisë Komunale me datë 11.07.2014, formohet komisioni për vërtetimin e gjendjes rreth përfundimit të punimeve në fshatin ..., me ç’rast është konstatuar se nuk janë përfunduar punimet ashtu që në thesar është penguar pagesa e fundit e kompanisë “ ... ”. Të akuzuarit S.M., V.K. dhe Z.S., në cilësinë e komisionit për pranimin teknik të punimeve, duke e shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar me qëllim që të përfitojnë çfarëdo dobie për vete dhe pronarin e kompanisë “ ... ” F.E. edhe me qëllim të dëmtimit të Komunës së Kllkotit nuk i kanë ndërmarr veprimet e duhura si komision për vlerësimin e gjendjes reale të asfaltimit të rrugicave në fshatin ... ashtu që si komision kanë dalë në terren dhe kanë përpiluar procesverbalin për pranimin teknik se të gjitha aktivitetet e planifikuara sipas projektit të datës 21.10.2013, janë kryer sipas projektit dhe më pas janë pajtuar që kompanisë në fjalë të i realizohet pagesa, e që në bazë të ekspertizës të përmendur më lartë i ka shkaktuar komunës së Kllkotit dëmin prej 9.573,07 euro, duke ju shkaktuar dëm edhe banorëve të fshatin ... për mos asfaltimin e rrugës. I akuzuari F.E. në cilësinë e

personit zyrtar – menaxher i kompanisë “ ... ” duke e shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar ka tejkaluar kompetencat e tija me qëllim që të përfitoi dobi materiale për vete e në dëm të Komunës së Kllokotit, ashtu që me datë 18.11.2013, edhe pse ka qenë në dijeni se punët ndërtimore nuk i ka përfunduar sipas kontratës ka ushtruar kërkesë për pranimin teknik dhe kinse janë kryer punët sipas planit dhe para masës sipas kontratës KII660/13/017/521 të datës 21.10.2013, për asfaltimin e rrugicave në fshatin ..., e që është në kundërshtim me raportin e komisionit për vërtetimin e gjendjes faktike për ndërtimin e rrugëve në fshatin ... me nr. të protokollit ...të datës 14.07.2014, dhe ekspertizës. Dallimi për pranim teknik, faturës për pagesë dhe punëve të kryera në teren janë 250,70 metra rrugë të pa kryera në vlerë prej 9.573,07 euro. Faktin se asfaltimi i rrugicave në fshatin ... ka pasur devijime vërtetohet edhe nga dëshmia e kryetarit të Komunës së Kllokotit S.S., i cili pas marrjes së detyrës ishte njoftuar se projekti i theksuar më lartë nuk ishte përfunduar në tërësi, dhe nga komisioni për pranim teknik është pranuar si i kryer, ashtu që kishte urdhëruar komisionin në përbërjen e njëjtë që të bëjnë matjen e rrugëve në teren ashtu që me datë 10.07.2013 komisioni kishte dalë në terren dhe kishte konstatuar se projekti nuk kishte përfunduar dhe se mungonin rreth 180 metra gjatësi. Po ashtu kryetari i komunës me vendim nr. 4853/1 të datës 11.07.2014 ka caktuar komisionin e ri i cili ka dalë në terren dhe kanë konstatuar se ka pasur devijime të projektit tek krahu katër dhe krahu dy në sipërfaqe prej 273 metrave. Pos deklaratave të akuzuarve dhe dëshmitarëve fajësia e të akuzuarve provohet edhe me provat materiale edhe atë raporti inicial, kontrata me titullin asfaltimi i rrugicave në Gërinqar me KII660/13/017/521 të datës 21.10.2013, raporti i organit mbikëqyrës i datës 08.11.2013, raporti i komisionit për pranimin teknik i datës 04.12.2013, deklarata e komisionit për pranim teknik e datës 10.04.2014, vendimi i komisionit për vlerësimin e gjendjes faktike i datës 11.07.2014, raporti i komisionit për vërtetimin e gjendjes faktike të rrugicave në fshatin ... i datës 14.07.2014, kërkesa për ekzekutimin e borxhit e bërë Thesarit e datës 07.03.2014, fatura nr. 009/13, në vlerë prej 14.751,59 euro, libri ndërtimor i “ ... ”, kërkesa për pranim teknik e datë 18.11.2013, ekspertiza e ekspertit të ndërtimtarisë e datës 07.08.2015, autorizimi nr. 091/2014 e datës 13.01.2014, vendimi i “ ... ” i datës 01.11.2013 si dhe foto dokumentacioni. Andaj konsiderojmë se me veprimet e të akuzuarve përmbushen elementet e veprës penale nga neni 422 të KPRK-ës, dhe se të akuzuarit i kanë kryer veprat penale në vendin, mënyrën si në dispozitiv të aktakuzës dhe i propozon Gjykatës që të njëjtit ti shpalli fajtor dhe ti dënoi me dënim meritior sipas KPRK-ës. Me rastin e matjes së dënimit të merren parasysht rrethanat rënduese si shkallën e rrezikshmërisë shoqërore, mënyrën e kryerjes, si dhe faktin se të akuzuarit nuk e kanë pranuar fajësinë.

Përfaqësuesi i të dëmtuarës Komuna e Kllokotit N.N., në fjalën përfundimtare deklaroi: se e përkrahu në tërësi fjalën përfundimtare të prokurorit të shtetit dhe shtoi se i bashkëngjitëm ndjekjes penale ndaj të akuzuarve ndërsa nuk ushtroi kërkesë pasuroro juridike.

Dëshmitari S.M. deklaroi se deri në përfundim të vitit 2013 kam qen Kryetar i Komunës së Kllokotit dhe se në rastin konkret është formuar komisioni për pranimin

teknik bazuar në ligj. Komisioni me sa më kujtohet ka dalë në terren dhe lidhur me pranimin e punimeve e ka njoftuar Administratën e Komunës e jo mua drejtpërsëdrejti. Në këtë rast e di se ka qenë fundi i mandatit tim dhe nuk e di e a kam nënshkruar lidhur me pagesën. Sa i përket mos pagesës dhe bllokadës në trezor nuk e di se kush e ka bërë këtë ndoshta kryetari i tanishëm i komunës. D. është caktuar si mbikëqyrës ngase Kllokoti është komunë e vogël dhe i njëjti është zgjedhur por nuk e di që D. të ketë kërkuar të mos jetë mbikëqyrës i projektit. Po ashtu edhe anëtarët e komisionit janë me shkollë të mesme edhe të larta përveç S. i cili është sociolog. Nuk e di se të njëjtit a e kanë pasur projektin për ndërtimin e rrugës dhe çfarë mjetesh kanë pasur me rastin e daljes në teren. Në komision nuk ka qenë asnjë anëtar me profesionin e ndërtimtarisë pasi që në komunë nuk kemi pasur një kuadër të tillë, pra të njëjtit nuk kanë qenë profesional por mund të them se të gjithë ata janë shumë të ndershëm dhe nuk kam dyshuar në ndershmërinë e tyre. Me anëtarët e komisionit në asnjë rast nuk kam biseduar me të njëjtit për realizimin e punimeve të rrugëve në fshatin G.r dhe as që kam ndikuar tek anëtarët e komisionit për pranimin teknik të punimeve. Unë nuk kam informatat lidhur me keqpërdorimin e punimeve të rrugës në fshatin G., pasi që lidhur me këtë çështje nuk ka pasur kurrfarë bisede në komunë. Nuk kam njohuri se a është përfunduar projekti, por nuk është logjike që diçka të paguhet që nuk është përfunduar.

Dëshmitari S.S. deklaroi: se në mars të vitit 2014 është bërë një kontrollë në komunë dhe jam informuar se rruga në fshatin ... nuk është përfunduar në tërësi me sugjerimin e revizionit në cilësi të kryetarit të komunës kam formuar komisionin për të verifikuar se a është përfunduar rruga sipas projektit. Komisioni ka dalë në vendin e ngjarjes dhe ka konstatuar se mungojnë rreth 270 metra rrugë. Kompania e cila i ka kryer punimet ka bërë kërkesë për pagesën e detyrueshme në vlerë prej 15.000 euro, ne kemi bërë kundërshtim në thesar në mënyrë që mos të bëhet pagesa dhe kemi paraqitur rastin në polici. Kemi arritur që të mos realizohet pagesa dhe në këtë mënyrë komuna nuk është dëmtuar porse ka pasur tentim që pagesa të realizohet. Të akuzuarit janë viktimat të ish menaxhmentit të Komunës së Kllokotit dhe të njëjtit i kanë detyruar të nënshkruajnë disa gjëra që nuk është dashur të nënshkruajnë dhe konsideroi se ish kryetari i komunës ka pasur njohuri për këtë. E di që D.S. ka kërkuar që të mos bëhet pagesa lidhur me këtë projekt deri sa i përket anëtarëve të komisionit nuk ka qenë profesional sa i përket përgatitjes shkollore. I akuzuari F.E., ka kërkuar realizimin e kërkesës prej 15.000 euro por unë kam kuptuar se projekti nuk është përfunduar dhe nuk kam dashur të ia bëjë pagesën edhe pse sipas letrave projekti ka qenë i përfunduar.

Eksperti në cilësinë e dëshmitarit H.I., deklaroi: se sipas kontratës asfaltimi i rrugëve në fshatin ... ka qenë në vlerë prej 49.751 euro, deri sa vlera e punimeve sipas ekspertizës ka qenë 40.178,51 euro, dhe ky dallim është marrë në sipërfaqe pasi që kontrata ishte e hartuar në sipërfaqe e jo në metër gjatësi, ashtu që unë e kam nxjerrë sipas sipërfaqes dhe sipas çdo pozicioni veç e veç dhe dallimi është sipas sipërfaqes së asfaltit dhe dallimi është në sipërfaqe prej 619.36 metra katror, përkatësisht metër gjatësi 250,70 metra, sipas para masave të tenderit – kontratës së punimeve. Në raport me kontratë pjesa e pa kryer e punimeve në vlerë monetare është 9.573,07 euro, por të gjitha

rrugët kanë qenë të shtruara aty ku ka pasur banor. Në këtë tender nuk ka pasur të hartuar projekt detal, por sipas tenderit ka qenë e paraparë 2.118,78 metra katror dhe gjatësia e rrugës ka dalluar sipas krahut të rrugës. Pra dallimi në mes të punëve të kryera dhe vlerës së kontratës është në lartësi prej 9.573,07 euro, derisa në raport kam konstatuar se në rastin konkret operatori ekonomik apo kryerësi i punëve është paguar më pak për 5.178,52 euro.

Mbrojtësi i të akuzuarit D.S., av. A.L., në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se në rastin konkret pas administrimit dhe shtjellimit të provave në veprimet e të pandehurit D.S., nuk janë përmbushur elementet e veprës penale për të cilat akuzohet pasi që për ekzistimin e kësaj vepre është i nevojshëm përfitimi material apo jo material për vete apo për personin tjetër çka do të thotë se në rastin konkret ky element nuk përmbushet. I akuzuari me një vendim të kryetarit të komunës është emëruar në cilësinë e organit mbikëqyrës për asfaltimin e rrugëve në fshatin ... edhe pse i njëjti e kundërshtuar këtë punë ngase nuk është ekspert në mungesë të arsimimit adekuat. I mbrojturi im si organ mbikëqyrës në përpilimin e procesverbalit është bazuar në gjendjen faktike duke u bazuar që asfalti është shtruar dhe duke u bazuar në fjalët e kryetarit të atëhershëm të komunës dhe të pune kryerësit se punimet kanë përfunduar, duke rekomanduar zyrës së financave të kryehet pagesa, duke llogaritur se punët janë kryer sipas përmasave nga kontrata. Komisioni me rastin e daljes në teren nuk ka pasur kopjen e projektit pasi që sipas arsyetimit nuk ka pasur as në komunë por që vetëm të mbrojturit tim i është thënë se asfaltimi duhet të bëhet për gjatë rrjetit të kanalizimit i cili ishte kryer më parë, dhe sipas deklaratës së pune kryerësit pjesa e rrugës është kryer në tërësi. Pra i akuzuari me asnjë rast nuk ka vepruar me vetëdije duke marr parasysh nivelin e shkollimit dhe mungesën e njohurive rreth vlerësimeve të projekteve. Me rastin e daljes së më vonshme në teren i akuzuari D. ka vërejtur se rruga nuk është përfunduar ashtu që menjëherë ka informuar se zyrtarët e financave në komunë nëse është e mundur mot ti bëhet pagesa punë kryerësit ngase ka vërejtur se është bërë gabim pasi që nuk është ekspert për vlerësimin konkret të planit. Edhe me dëgjimin e dëshmitarëve S.M., se ish kryetari i komunës së Kllokotit i cili deklaroi se të gjithë tani të akuzuarit janë të ndershëm dhe mendoi se nuk janë fajtor, e edhe nga dëshmia e dëshmitarit S.S. – kryetar aktual i komunës së Kllokotit rezultoi se i mbrojturi im si dhe të akuzuarit tjerë janë viktimat të menaxhmentit të mëhershëm të komunës së Kllokotit, e edhe duke pasur vërejtje në ekspertizën e ekspertit H.I., konsideroi se i mbrojturi im D.S. nuk është fajtor për veprën penale për të cilën akuzohet dhe konsideroi se i akuzuari nuk e ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari D.S. ka deklaruar: se në Komunën e Kllokotit punoi që nga viti 2010, dhe në rastin konkret nga kryetari i komunës jam urdhëruar që të jem mbikëqyrës i punimeve edhe pse unë nuk kam dashur pasi që nuk jam profesionist. Unë kam dalë në teren për të parë zhvillimin e punimeve duke mos pasur asnjë projekt as skicë, dhe se kryetari i komunës më ka thënë se deri ku ka qenë rruga pra deri ku ka qenë edhe rrjeti i kanalizimit. Sipas mendimit tim kam mendu se projekti ka kaluar në mënyrë të rregullt, por që unë për këtë se diçka nuk ishte në rregullt kam kuptuar kur ka ardhur revizioni dhe për këtë unë e kam informuar kryetarin e komunës si dhe kam biseduar me zyrën e financave

në kuadër të komunës dhe përmes deklaratës me shkrim kemi kërkuar që mos bëhet pagesa pasi që nuk janë përfunduar punët. Unë e kam nënshkruar një raport të përgatitur tek kryetari i komunës i cili ka qenë i gatshëm por që unë të njëjtin nuk e kam përpiluar. Po ashtu lidhur me mbikëqyrjen e projektit unë nuk kam marur asnjë pagesë shtesë përpos të ardhurave personale. Unë kam konsideruar se rruga ka qenë e përfunduar ashtu siç më ka rekomanduar kryetari deri aty ku përfundon edhe rrjeti i kanalizimit dhe se deri aty edhe është përfunduar rruga dhe se po ta kisha ditur se nuk është përfunduar rruga nuk do ta kisha nënshkruar raportin, pra unë nuk e di se si është llogaritur me metra katror asfaltimi i rrugës dhe për këtë kam marr vesh kur ka ardhur revizioni, por unë e kam ditur se rruga duhet të asfaltohet deri ku ka përfunduar edhe rrjeti i kanalizimit. Lidhur me këtë rast nuk kam pasur kurrfarë përfitimi as për veti e as për dike tjetër dhe me sa jam i informuar shuma e parave nuk i është lëshuar kompanisë çka mendoj se në këtë raste komuna e Kllokotit nuk është dëmtuar. Andaj duke e përkrahur fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim kërkoj ka gjykata që të lirohem nga përgjegjësia penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit sipas detyrës zyrtare, S.M. av. V.I. në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se në të gjitha fazat e procedurës i mbrojturi im ka mohuar ta ketë kryer veprën penale në bashkëkryerje me të akuzuarit V.K. dhe Z.S. keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1. lidhur me nenin 31 të KPRK e cila i vihet në barrë sipas aktakuzës. Me dëgjimin e dëshmitarëve në këtë çështje juridiko – penale me asnjë deklaratë si dhe me dëgjimin e palëve të dëmtuara nuk është theksuar se i mbrojturi im është kryerës i veprës penale për të cilën akuzohet, pasi që S.M. si ish kryetar i komunës ka deklaruar se ai ka formuar komisionin për pranimin teknik për asfaltimin e rrugës në f. ..., e i cili komision sipas tij nuk ka qenë profesional dhe më tej ka theksuar se komisioni i cili ka pranuar punimet nuk kanë keqpërdor punimet në rregullimin e kësaj rruge. Edhe kryetari i deritanishëm i komunës S.S. i dëgjuar në cilësinë e dëshmitarit i cili ka hequr dorë nga kërkesa pasuroro juridike pasi që komuna nuk është palë e dëmtuar, pasi që komisioni nuk ishte profesional dhe i manipuluar nga ish kryetari i komunës S.M.. Andaj propozoi gjykatës që ndaj të mbrojturit tim S.M. të bie aktgjykim lirues pasi që me asnjë provë nuk është provuar që i njëjti ka kryer veprën penale për të cilën akuzohet.

I akuzuari S.M. ka deklaruar: se në komunën e Kllokotit punoi që nga viti 2010, në Departamentin për Shëndetësi. Sa i përket rastit konkret është e vërtetë se kam qenë anëtar i komisionit për pranimin teknik të punimeve për asfaltimin e rrugëve në fshatin ... dhe aty më ka përzgjedhur kryetari i komunës, porse unë me atë raste i kam thënë se a duhet unë përsëri të jem anëtar i komisionit ngase nuk ishte hera e parë që isha anëtar i komisionit. Ditën kur është marr vendimi ka ardhur zyrtari i firmës i cili ka pasur një projekt lidhur me ndërtimin e asaj rruge deri sa unë si anëtar i komisionit e kam pa projektin, porse nuk kam pasur njohuri që ta kuptoi atë, nuk kam ditur as lidhur me gjatësinë, gjerësinë e as trashësinë si dhe sa metra katror duhet të shtroheshin. Kur kemi dalë në teren, po atë ditë e kemi marr vendimin nga kryetari se jemi përzgjedh si anëtar i komisionit porse ky vendim ka qenë i përpiluar disa ditë më parë, dhe kur më është dhënë vendimi na është thënë se rruga për në fshatin ... ka përfunduar dhe se kryerësi i

punimeve do të na dërgoi për pranimin e rrugës, ndërsa ne instrumente për matjen e rrugës nuk kemi pasur e nuk kemi pasur as veturë për të shkuar për në fshatin Kur kemi shkuar në fshatin ... kemi qenë tre anëtarët e komisionit, organi mbikëqyrës D.S. si dhe ka qenë kryerësi i punëve e emrin e të cilit nuk e di. Atë ditë kemi vërejtur disa parregullsi siç është: shaktat kanë qenë në nivelin e asfaltit, si dhe një kanal për ujërat atmosferike ka qenë i pa përfunduar. Atë ditë nuk e kemi hartuar procesverbalin, por pas 2-3 ditëve e kemi hartuar procesverbalin për pranim dhe D.S. nga fshatin ... kanë shikuar se kryerësi i punimeve i ka ngritur shaktat në nivelin e asfaltit dhe dikush nga punë kryerësi e ka sjellë raportin lidhur me kualitetin e asfaltit. Gabimi i vetëm është se ne nuk kemi bërë matjen e gjatësisë së rrugës së asfaltit ngase nuk kemi pasur as me çka ta matim. Unë kam menduar se çdo gjë ka përfunduar ngase kur është hartuar procesverbali nga V. dhe D. na është thënë se janë përmirësuar shaktat dhe po ta kisha ditur se një pjesë e rrugës nuk është asfaltuar nuk do ta kisha nënshkruar kurrë procesverbalin. Dua të shtoi se unë nuk kam pasur kurrfarë përfitimi nga askush lidhur me punimet në këtë projekt, andaj e përkrahu në tërësi fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe kërkoi nga trupi gjykues që të lirohet nga akuza.

Mbrojtësi i të akuzuarit sipas detyrës zyrtare, V.K. av. B.H. në fjalën përfundimtare deklaroi: se gjatë shqyrtimit gjyqësor nuk është vërtetuar se i akuzuari V.K., të ketë kryer veprën penale për të cilën akuzohet ngase nuk është vërtetuar se Komuna e Kllokotit është dëmtuar në vlerë prej 9.573,07 euro, siç pretendohet në aktin akuzues ngase kjo shumë nuk është paguar pasi që punimet nuk janë kryer siç është paraparë, por që të njëjtit (komisioni) në deklaratën e datës 10.07.2014 me nr. të protokollit nr. ... e ka njoftuar kryetarin e komunës dhe drejtorin e financave që të mos e bëjë pagesën ndaj kompanisë ngase nuk është kryer puna siç duhet por të njëjtit kanë zbatuar urdhëresën e kryetarit të mëhershëm të komunës. Po ashtu anëtarët e komisionit asnjëri nga ata nuk është pyetur se a dëshirojnë të bëhen anëtarë të komisionit por që të njëjtit nuk kanë pasur përgatitjen profesionale për vlerësimin e projektit. Në aktakuzë thuhet se në rastin konkret kanë menduar 180 metra rrugë e asfaltit dikund 250 metra e madje edhe dikund tjetër 273 metra, derisa përfaqësuesi i Komunës së Kllokotit ka deklaruar se nuk është dëmtuar financiarisht komuna nga mos përmbushja e tërësishme e kontratës për asfaltimin e rrugëve në f. ... e as banorët e këtij fshati, pasi që kanë qasje në rrugë të asfaltuar dhe nuk kanë kërkuar kompenzim. Poashtu ekspertiza e ekspertit të ndërtimitarisë është me shumë të meta sa i përket pjesës përlllogaritjes. Poashtu edhe dëshmitari kryetar aktual i komunës S.S. ka deklaruar se tani të akuzuarit janë viktime sikurse edhe shumë të tjerë dhe janë shfrytëzuar nga kryetari i atëhershëm i Komunës, andaj nga të theksuarat e përmendura më lartë nuk është vërtetuar se të njëjtit e kanë kryer veprën penale për të cilën akuzohen dhe kërkojmë nga Gjykata që të nxjerr aktgjykim lirues.

I akuzuari V.K. ka deklaruar: se unë në Komunën e Kllokotit punoi si shef i mbrojtjes sociale dhe në atë kohë kam qenë edhe anëtar i komisionit për pranimin teknik të rrugës së asfaltuar në fshatin Gërmaqar. Se jam anëtar i komisionit kam kuptuar në momentin kur na është ofruar procesverbali për pranimin teknik të asfaltit dhe askush nuk

më ka pyetur se a dëshiroi të jem anëtar i komisionit për pranimin teknik. Në teren kemi dalë së bashku me punë kryerësin me veturën e tij dhe paraprakisht unë nuk e kam parë projektin për atë rrugë deri sa nga zyra e kryetarit na kanë njoftuar se rrugën duhet të shkoj përkatësisht të përfundoj deri aty ku përfundon edhe rrejtja e kanalizimit. Pas një kohe kur ka ardhur revizioni unë kam kuptuar se mungon një pjesë e asfaltit ashtu që ne për këtë ju kemi drejtuar kryetarit të komunës në mënyrë që të mos i bëhet pagesa punë kryerësit, dhe mendoi se pagesa punë kryerësit nuk i është bërë në tërësi. Konsideroi se me këtë rast komuna nuk është dëmtuar pasi që pagesa nuk është realizuar në tërësi. Matjen ne si anëtarë të komisionit nuk e kemi bërë ngase nuk kemi pasur mjete dhe projektin nuk e kam kuptuar, por që i kemi besuar kryetarit të komunës që asfalti duhet të shtrohet deri ku përfundon edhe rrjeti i kanalizimit. Andaj duke e përkratur fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim avokat B.H., kërkoi nga trupi gjykues që të më liroi nga përgjegjësia penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit Z.S., sipas detyrës zyrtare av. M.A., në fjalën përfundimtare ka deklaruar: se me shtjellimin e provave dhe marrjen në pyetje të dëshmitarëve me ekspertizën financiare, me leximin e provave tjera materiale dhe marrjes në pyetje të të akuzuarit konsideroi se në veprimet e të akuzuarit nuk përmbushen elementet e veprës penale nga neni 422 par.1. të KPRK-ës, ngase sipas përkufizimit ligjor keqpërdorimi i pozitës zyrtare apo autoritetit zyrtar ekziston kur personi zyrtar duke shfrytëzuar detyrën apo autoritetin zyrtar i kalon kompetencat e tij ose nuk i përmbush detyrat me qëllim të çfarëdo dobie për vete apo personit tjetër, apo ti shkaktoi dëm personit tjetër. Pra keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar ekziston vetëm kur bëhet me qëllim të sjelljes së dobisë apo shkaktimeve të dëmit me dashje të drejtpërdrejtë me dijeninë e kryerësit se po e shfrytëzon pozitën e tij zyrtare, po tejkalon kompetencat e tij, ose nuk e kryen detyrën e tij dhe faktin se me këtë përfiton dobi pasurore për vete apo për tjetrin ose i shkakton dëm tjetrit. Nga provat e administruara nuk është kontestuese se i akuzuari Z.S. ka qenë anëtar i komisionit për pranimin teknik të rrugës të ndërtuar në f.shatin ... edhe pse kjo detyrë nuk ishte nga profesioni i tij por i ishte imponuar nga eproroi ashtu që i akuzuari nuk ka guxuar ta refuzoi nga frika e rrezikimit të vendit të punës. Andaj duke pasur parasysh gjendjen faktike në këtë çështje penale vlerësoi se në prani të këtyre fakteve të vërtetuara vërtetohet se i akuzuari duhet të lirohet ngase gjatë procedurës nuk është vërtetuar se i njëjti ka përfituar ndonjë dobi materiale por edhe Komuna nuk është dëmtuar ngase kryerësit të punimeve nuk i është paguar shuma prej 9.000 euro për pjesën e pa përfunduar të rrugës.

I akuzuari Z.S., ka deklaruar se në Komunën e Kllokotit punoi që nga viti 2009, si punëtor social në të njëjtin shërbim. Në komision për pranimin teknik të rrugës së asfaltuar në fshatin ... jam caktuar me një vendim të cilin nuk e kam mirëpritur. Lidhur me këtë çështje kam biseduar me kryetarin e komisionit për pranimin e kësaj rruge ngase ditën kur e kam marr vendimin diku pas gjysmë ore na është dashur të dalim në teren dhe na është thënë se puna është urgjente ngase projekti është kryer nga firma punë kryerëse dhe të njëjtit duhet ti bëhet pagesa. Ne si komision kemi dalë në teren pra kemi qenë tre anëtar dhe kryetari i komisionit dhe në teren kemi shkuar me veturën e ndërmarrjes e cila

i ka kryer punët dhe aty ka qenë një punëtor i firmës, por jo tani i akuzuari. Me atë rast e kam pyetur kryetarin e komisionit për projektin dhe mjetet tjera teknike për matjen e rrugës, i njëjti më ka thënë se kemi një dokument por që është problem ta kuptojmë ato vija teknike, por kemi një raport të organit mbikëqyrës të punimeve e në të cilin raport është pa se punimet janë kryer dhe do të na ndihmoi në pranimin teknik të punimeve. Mjete për matje nuk kemi pasur, koha ka qenë me shi dhe në teren përfaqësuesi i firmës na ka njoftuar për përfundimin e punimeve duke lëvizur me veturë e duke na dhënë sqarime dhe ne jemi munduar që ta shohim rrugën duke lëvizur me veturë lidhur me atë se a ka bankina, pjesë të nevojshme të betonit se a është rregulluar anash me zhavorr dhe kemi arritur deri në fund të rrugës së përfunduar, e pastaj përfaqësuesi i ndërmarrjes na ka thënë se këtu është përfundimi i rrugës. Kryetari i komisionit me këtë rast ka vërejtur parregullsi lidhur me disa pus-eta të kanalizimit dhe është kërkuar që ato të rregullohen si dhe ti bëhet analizë kualitetit të asfaltit, por përfaqësuesi i firmës ka deklaruar se sa i përket analizave këto janë bërë dhe të gjitha janë në rregull. Nuk e di se a e kemi bërë atë ditë pranimin teknik apo një ditë tjetër dhe kryetari i komisionit ma ka sjellë dokumentin për pranim teknik dhe unë vetëm se e kam nënshkruar pa e lexuar përmbajtjen e tij. Urdhëresë nuk ka pasur për të bërë pranimin teknik por ka pasur preferenca që ky pranim të kryhet dhe ti bëhet pagesa ndërmarrjes punë kryerëse dhe ne punët si anëtar të komisionit e kemi bërë pa kurrfarë kompensimi. Me tu konstatuar se puna nuk ishte kryer ashtu që ne si komision kemi bërë një deklaratë të cilën e ka hartuar kryetari i komisionit dhe përmes kësaj është kërkuar që të mos bëhet pagesa e punëve të pa kryera. Nga ky projekt nuk kam përfituar asgjë por problemeve që më janë shkaktuar e edhe komuna nuk ka pasur kurrfarë dëmi material ngase pagesa nuk është bërë për punët e pa kryera. Andaj duke e përkrahur fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim avokat M.A. kërkoi nga trupi gjykues që të më liroi nga përgjegjësia penale.

Mbrojtësi i të akuzuarit F.E., sipas detyrës zyrtare av. E.Q., në fjalën përfundimtare deklaroi: nuk qëndron konstatimi nga aktakuza se i mbrojturi im është kryerës i veprës penale e cila i vëhet në barrë të parapara me nenin 422 par.1. të KPRK-ës, ngase në këtë rast veprimi i kryerjes është përcaktuar në mënyrë alternative dhe përbëhet nga këto forma: keqpërdorimi i pozitës zyrtare, tejkalimi i kompetencës dhe mos përmbushja e detyrave të tija zyrtare, pra duhet të përmbushet ndonjëra nga këto elemente. Nuk janë cituar faktet vendimtare për veprën penale për të cilën akuzohet i mbrojturi im dhe se e njëjta kryhet me dashje dhe nuk rezulton figura e veprës penale dhe i cili është element subjektiv pra qëllimi i përfitimit të kundërligjshëm, i dobisë pasurore për vete apo për personin tjetër, apo dëm të shkaktuar personit tjetër e çka nuk është vërtetuar në rastin konkret. Sipas dispozitivit të aktakuzës e me të cilën ngarkohet i akuzuari nuk shihet se kujt i është shkaktuar dëm e po ashtu si është shkaktuar ai dëm dhe kush ka përfituar dobi pasurore të kundërligjshme. Në veprimet e të mbrojturit tim nuk mund të gjendet asnjë element i ekzistimit të veprës penale për të cilën i njëjti akuzohet. Po ashtu vlen të theksohet se i akuzuari F.E. nuk është person zyrtar andaj cilësimi i kësaj vepre penale sa i përket F.E. është i gabuar ngase nuk është në harmoni me nenin 120 par.2. të KPRK-ës. nga provat e administruara e edhe ekspertiza e bërë nuk rezulton se i akuzuari F. ta ketë dëmtuar ndokënd, por nga kjo ekspertizë rrjedhë se

Komuna e Kllokotit në këtë rast i ka mbetur pa i paguar kryerësit të punimeve vlerën prej 5.178,52 euro ngase i akuzuari si i autorizuar i kompanisë “ ... ” pas pranimit të raportit dhe komisionit për pranim teknik e së bashku me organin mbikëqyrës të komunës me datë 04.12.2013 kanë konstatuar se janë përfunduar të gjitha punimet andaj edhe ka bërë faturimin e shërbimeve. Komuna e Kllokotit ka mundur ta kontestoi faturën e dorëzuar përmes mjeteve të rregullta të drejtësisë civile dhe se këto veprime të të akuzuarit nuk përmbajnë vepër penale. Andaj pasi që nuk është provuar se i akuzuari F. ka kryer vepër penale propozoi Gjykatës që duke vendosur në mënyrë të drejtë dhe meritore të akuzuarin ta liroi nga përgjegjësia penale.

I akuzuari F.E., ka deklaruar: se në komunën e Kllokotit kemi bërë një kontratë deri sa projekt nuk kemi pasur për asfaltimin e rrugicave në fshatin Kemi kontaktuar me organin mbikëqyrës dhe i njëjti i ka përcaktuar pikat nga fillimi i punimeve pasi që projekt nuk ka pasur dhe kemi filluar punën duke u konsultuar me organin mbikëqyrës. Pasi që i kemi përfunduar punimet të përcaktuara nga organi mbikëqyrës ne ju kemi drejtuar me shkrim komunës për pranimin teknik të punimeve dhe pranimin teknik e ka bërë komisioni i caktuar nga komuna. Unë nuk kam kontaktuar me asnjërin nga anëtarët e komisionit e as që kam dalë në teren me komisionin. Në bazë të kërkesës për pranimin e punimeve, organi mbikëqyrës së bashku me komisionin kanë bërë raportin se janë kryer të gjitha punimet duke mos pasur vërejtje as në cilësi e as në sipërfaqe të asfaltit ashtu që ne e posedojmë raportin lidhur me pranimin teknik dhe letër-referencën për kryerjen e punimeve në bazë të kontratës të cilën e lëshon kryetari i komunës me drejtorin e prokurimit. Faturimi për lartësinë e pagesës është bërë në bazë të raportit të komisionit për pranim teknik i cili ka konstatuar se janë kryer punimet dhe pagesa të bëhet sipas kontratës dhe në këtë rast pagesa është bërë në vlerë prej 36.000 euro deri sa nuk është bërë pagesa në shumën prej 15.000 euro. Çmimi është përcaktuar në bazë të para - masave dhe çmimit të tregut dhe është pjesë e kontratës dhe se a ka pasur devijim të kontratës këtë ka qenë i obliguar ta bëjë komisioni për pranimin teknik. Konsideroi se 90% të punimeve janë përfunduar dhe nga kryetari i komunës kam kërkuar që për pjesën e mbetur të hiqet vlera për pagesë prej 9.000 euro. Andaj e përkrahu fjalën përfundimtare të mbrojtësit tim dhe kërkoi nga trupi gjykues që të më liroi nga përgjegjësia penale.

Gjykata bëri shtjellimin dhe analizimin e provave materiale edhe atë: raporti i datës 14.07.2014 lëshuar nga komisioni për vërtetimin e gjendjes faktike të rrugës në fshatit ..., fatura me nr. ... e datës 04.12.2013, kërkesa për pranim teknik e datës 18.11.2013, kontrata e punës për asfaltimin e rrugëve në fshatit ... e lidhur me Ndërmarrjen “ ... ”, raporti mbi kryerjen e punëve në asfaltin e rrugëve në fshatin ... e datës 08.11.2013, procesverbali mbi pranimin teknik të rrugëve në fshatn ..., deklarata për asfaltimin e rrugëve në fshatin ... e datës 10.07.2014, deklarata për projektin e asfaltimit të rrugëve e datës 10.07.2014, libri ndërtimor i ndërmarrjes “ ... ”, autorizimi nr. 091/2014 i datës 13.01.2014 dhe ekspertiza e ekspertit të ndërtimtarisë e datës 07.08.2015 dhe foto dokumentacioni.

Pas shtjellimit dhe analizimit të gjitha provave veç e veç dhe të gjithave së bashku si në kuptim të nenit 8 dhe 361 të KPPRK gjykata konstatoi këtë gjendje faktike se komuna e Klllokotit me datë 21.10.2013 ka lidhur kontratë me ndërmarrjen “ ... ” për asfaltimin e rrugicave në fshatin ... me të cilën është përcaktuar edhe çmimi i punimeve në vlerë prej 49.751,59 euro, deri sa i autorizuari i ndërmarrjes ka qenë F.E.. Komuna e Klllokotit ka emëruar organin mbikëqyrës të punimeve D.S., si dhe komisionin për pranimin teknik të punimeve në përbërje prej S.M., V.K. dhe Z.S.. Komisioni për pranimin teknik të punimeve pasi që kishte marr informacionin nga organi mbikëqyrës për kryerjen e punimeve dhe kërkesës së punë kryerësit për pranimin teknik të punëve në asfaltimin e rrugicave në ..., ishte udhëzuar nga kryetari i komunës që të dali në vendin e ngjarjes dhe të bëjë pranimin teknik të punimeve. Komisioni së bashku me punë kryerësin kishin dalë në vendin e ngjarjes por duke mos iu ofruar ndonjë projekt për kryerjen e punimeve por duke ju sugjeruar që punimet duhet të shkonin deri në vendin ku ishte shtrirë rrjeti i kanalizimit sikundër duke mos qenë kompetent pasi që nuk ishin profesionist të lëmisë përkatëse dhe duke mos pasur mjete për matjen e rrugës kishin konstatuar se në rrugë pustetat ishin nën nivelin e asfaltit dhe ato duhet të ngriteshin. Pasi që mbikëqyrësi i punimeve D.S. i cili ishte nga i njëjti fshat dhe kishte konstatuar se pusetat janë rregulluar nga punë kryerësi, me datë 25.11.2013 komisioni ka konstatuar se punimet janë kryer sipas projektit dhe janë pajtuar që punëkryerësit ti bëhet pagesa sipas procedurës financiare. Punë kryerësit “ ... ” në këtë rast i është bërë pagesa prej 35.000 euro. Me rastin e auditimit është konstatuar se në këtë projekt në përmasa dhe parallogarit është bërë gabim ashtu që mbikëqyrësi i punimeve ka konstatuar se nuk janë përfunduar punimet në tërësi sepse gjatësia është diku 180 metra të pa asfaltuara. I njëjti - mbikëqyrësi i punimeve i ka njoftuar zyrtarët e financave se është bërë gabim duke qenë se nuk ka qenë ekspert dhe ka vepruar sipas vendimit të kryetarit të komunës dhe ka kërkuar që mundësisht pjesa tjetër e pagesës mos të bëhet. Komisioni në përbërje të S.M., V.K. dhe Z.S. me datë 10.07.2014, me anë të një deklaratë për asfaltimin e rrugëve në fshatin ... me nr. 4848/6 të datës 10.07.2014 ju ka drejtuar kryetarit të komunës si dhe drejtorit për financa dhe ka njoftuar se të njëjtit me rastin kur janë caktuar si anëtar të komisionit me datë 25.11.2013 nuk jemi konsultuar se a dëshirojmë të jemi anëtar të komisionit por vetëm jemi urdhëruar që të dalim e ta pranojmë rrugën duke mos ditur detajet si dhe mos ditur ta lexojmë projektin kanë besuar se projekti është realizuar dhe rruga të kaloj andaj ku është i përfunduar edhe rrjeti i kanalizimit, e për të cilën e ka vërtetuar edhe punë kryerësi së bashku me punë kryerësin ashtu që është bërë edhe pranimi teknik. Mirëpo më pas është konstatuar se projekti nuk është përfunduar deri në fund dhe mungojnë edhe 180 metra rrugë të pa asfaltuara. Më pas komuna e Klllokotit me vendimin nr. 4853/1 të datë 11.07.2014, ka formuar komisionin për vlerësimin e gjendjes reale të asfaltimit të rrugës në Pasi që puna rreth asfaltimit të rrugëve në fshatin ... nuk ishte përfunduar në tërësi pjesa tjetër e mbetur e pagesës sipas kontratës nuk i ishte bërë punë kryerësit Ndërmarrjes “ ... ” ngase pagesa e kësaj pjesë të mbetur ishte ndaluar nga zyrtarët e Komunës së Klllokotit.

Nga një gjendje e këtillë e konstatuar faktike se organi mbikëqyrës i punimeve D.S. ishte caktuar nga kryetari i atëhershëm i komunës edhe pse i njëjti nuk ishte i

profesionit sikundër edhe anëtarët e komisionit për pranim teknik ishin të profesioneve tjera e jo nga lëmia e ndërtimtarisë si dhe duke u nisur nga fakti se të njëjtit nuk ishin refuzuar të jenë anëtarë të komisionit duke u frikuar se do të kenë pasoja në vendin e punës dhe kishin bërë pranimin teknik të punimeve pasi që paraprakisht ju kishte thënë se rruga duhet të asfaltohet deri aty ku përfundon rrjeti i kanalizimit, si dhe duke u nisur nga fakti se në momentin kur kishin kuptuar që një pjesë e rrugës nuk është përfunduar i kishin njoftuar zyrtarët komunal për këtë fakt në mënyrë që të mos bëhet pagesa në tërësi e punë kryerësit me deklaratat e dt. 10.07.2014, në veprimet e tyre nuk janë formuar elementet e veprës penale për të cilën akuzohen përkatësisht veprës penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1. KPRK-ës. për të ekzistuar kjo vepër penale e cekur më lartë personi zyrtar duhet që të i tejkaloi kompetencat e tij ose mos ti përmbush detyrat e tija zyrtare me qëllim që të fitoi çfarëdo dobie pasurore për vete apo për personin tjetër apo të i shkaktoi dëm personit tjetër ose shkel të drejtat e personit tjetër. Pra duhet që të përmbushet edhe elementi i dashjes për përfitime të dobisë pasurore ose shkaktimin të dëmit personit tjetër. Në rastin konkret me asnjë fjalë të vet me nuk është thënë se të akuzuarit D.S., S.M., V.K. dhe Z.S. të kenë përfituar dobi të kundërligjshme pasurore në këtë rast pasi që edhe kryetari i më parshëm i komunës e edhe kryetari aktual të dëgjuar në cilësi të dëshmitarit të akuzuarit i njohin si shumë të ndershëm. Po ashtu nuk është vërtetuar që me rastin konkret komuna e Kllokotit të jetë dëmtuar në vlerën prej 9.573,07 euro pasi që pagesa punë kryerësit nuk i ishte bërë, përkatësisht i ishte bërë vetëm vlera prej 35.000 euro, kjo vërtetohet nga ekspertiza e datë 07.08.2015. Se komuna nuk ishte dëmtuar vërtetohet edhe me faktin se i autorizuari i komunës N.N. nuk ka ushtruar kërkesë pasurore juridike e po ashtu edhe dëshmitari S.S. - Kryetar aktual i Komunës së Kllokotit deklaroi se komuna nuk është dëmtuar. Një gjë e tillë është vërtetuar edhe nga ekspertiza e ekspertit të ndërtimtarisë i datës 10.08.2015. Sa i përket të akuzuarit F.E. po ashtu nuk është vërtetuar se si përfaqësues – autorizuar i ndërmarrjes “ ... ” të ketë kryer veprën penale keqpërdorimi i pozitës apo autoritetit zyrtar nga neni 422 par.1. KPRK-ës, pasi që i njëjti si punë kryerës mbi bazën e kontratës mbi kryerjen e punimeve asfaltimit të rrugicave në fshatin ..., pasi që komisioni për pranim teknik të punimeve ka bërë kërkesë për pranimin teknik të punëve ishte bërë pagesa në shumë prej 35.000 euro, deri sa pjesa tjetër e pagesës sipas kontratës ishte ndaluar nga zyrtarët komunal dhe kjo pjesë e pagesës në shumë prej 9.573,07 euro nuk i është paguar, çka po ashtu vërtetohet nga ekspertiza. Pra lidhur me rastin konkret nuk është përmbushur elementi i veprës penale e fitimit të dobisë pasurore ngase të njëjtit pagesa nuk i ishte bërë të njëjtit, por edhe për faktin se i njëjti në bisedë me zyrtarët komunal ishte zotuar se pjesën e mbetur të punimeve do ta realizonte e më pastaj ti bëhet pagesa.

Andaj në mungesë të provave me të cilat do të vërtetohej se të akuzuarit i kanë kryer veprat penale për të cilat akuzohen dhe bazuar në nenin 364 u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës.

Vendimi mbi shpenzimet e procedurës penale, është i bazuar në nenin 454, të KPPRK-së.

Nga të cekurat më lartë u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
DEPARTAMENTI I KRIMEVE TË RËNDA
PKR.nr. 128/15 Me datë. 27.12.2016**

Sekretarja juridike,
Naile Neziri

Kryetari i trupit gjykues,
Agim Ademi

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë Departamenti për Krime të Rënda, në afat prej 15 ditësh nga dita e pranimet të së njëjtës, ankesa dorëzohet në dy ekzemplar përmes kësaj Gjykate.